Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	**24.10.2023**	**03.11.2023**	**2023/0792**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.10.2023, OE "Valmir Loshi B.I."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0792, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE INTERING CONSTRUCTION SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit: "FURNIZIM ME MATERIAL NDERTIMOR PER RASTET EMERGJENTE.(633-023-073-121)" me nr. të prokurimit: "633-23-9330-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E ISTOGUT.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë te hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 40,000.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 01.09.2023; data e hapjes së ofertës: 21.09.2023, data e njoftimit mbi vendimit e AK-se: 03.10.2023; data e njoftimit me letër standarde: 03.10.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

		Kërkesat e përshtatshmërisë: **Kërkesa 1 Deklaratë nën betim – Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbipërshtatshmërinë në pajtim me Ligjin mbi ProkuriminPublik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publiktë Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dheligjin Nr. 05 L-092 Ligjin Nr. 04 L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Deklarata nën betim – e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes).**
		b)Në dokument nga Administra Tatimore e vendit tuaj të themelimit,se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.	**b).Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje).**
		c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Qështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit).	**c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Qështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit). Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës.Në rast të dështimit në dorzimë të dokumentave të tilla,tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës.**

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
		Kërkesa 1.Certifikata e Regjistrimit te Biznesit (ARBK)	**Evidenca 1 - Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (ARBK) - kopje**
		Kërkesa 2.Regjistrimi i TVSH –së	**Evidenca 2 - Certifikata e TVSH-së kopje**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

		Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (furnizime)në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 60,000.00 €.	**Evidenca 1. OE duhet te ofroj deshmi a). Listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të ketij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE. b). Referencat ose raporte te pranimit në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës , datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive ose raportet e pranimit është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen raportet e pranimeve ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera) te lëshuara nga autoriteti i tillë. Për referenca nga institucionet private duhet te dëshmohet qarkullimi bankar origjinal nga banka për vlerën referencës së prezantuar.**
		Kërkesa 2 Mjetet, stabilimentet dhe paisjet teknike qe ju i posedoni minimum -Nje kamion transportues me kran.	**Dëshmia 2 Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe paisjeve- origjinal e nenshkruar dhe vulosur, per kamion transportues deshmi te pronesise (libreze valide) apo marrveshje per aktivitetin ne fjale te shfrytezimit nga ndonje kompani -te bashkangjitur librezen valide.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues eshte i papërgjegjshëm

OE i rekomanduar për kontrate eshte i përgjegjshëm

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Valmir Loshi B.I.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontaktues – Komuna e Istogut, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se, kryesisht nenin 59 të LPP-se, me këtë rast ka rekomanduar për kontrate një operatore ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes se tenderit.

Autoriteti Kontaktues – Komuna e Istogut, me datën 03.10.2023 ka publikuar njoftimin B46 - Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.

Autoriteti kontraktues pas pranimit te ofertave me datën: 21.09.2023, ka formuar komisionin për vlerësimin e ofertave, te cilët pas vlerësimit ne aspektin administrativ, bene vlerësimin e ofertës financiare duke bere llogarit, konkretisht marrin sasitë e përafërta dhe çmimin për njësi te dhënë nga operatoret ekonomik dhe ne fund te procesit, sipas komisionit vlerësues rezulton qe oferta e OE ankues është me shtrenjtë se oferta tjetër pjesëmarrëse.

Ndërsa sipas procesverbalit te hapjes, njeherit edhe sipas paramanës se hartuar dhe publikuar nga vet autoriteti kontraktues, rezulton se oferta e OE ankues Valmir Loshi B.I, është me

çmim me te lire për njësi.

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €
1.	Valmir Loshi B.I., GURRAKOC, -, ISTOG	21.09.2023	FURNIZIM ME MATERIAL NDERTIMOR PER RASTET EMERGJENTE.(633-023-073-121)	777.7
2.	INTERING CONSTRUCTION SH.P.K., RR.LIDHJA E PEJES, 31010, DOBRUSHË	888-HB	FURNIZIM ME MATERIAL NDERTIMOR PER RASTET EMERGJENTE.(633-023-073-121)	911.8

Pretendimi nr.1

OE ankues pretendon se AK – Komuna e Istogut me datën 01.09.2023 në platformën elektronike të prokurimit ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë OE INTERING CONSTRUCTION SH.P.K., ndërsa neve jemi cilësuar si tenderues i pasuksesshëm. OE ankues pretendon se kur analizohet procesverbali i hapjes dhe njoftimi mbi vendimin e AK-së, shihet që ne jemi ofertues më i lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë me çmime për njësi (totalin e njësive) ashtu siç është kërkuar. Ne kemi ofertuar me çmim prej 777.70 €, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej 911.85 €, prandaj OE i rekomanduar për kontratë nuk është dashur dhe nuk mund të shpallet fitues i kësaj kontrate.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se autoriteti kontraktues, ka bere vlerësimin se ofertave financiare ne kundërshtim me dispozitat e nenit 54 të rregullores Nr. 001/2022, sepse autoriteti kontraktues ne paramasen e publikuar ka dhënë sasitë e përafërta, prandaj fakti qe ka dhënë sasitë e përafërta tregon se këto sasi nuk janë definitive dhe njeherit lidhur me këtë çështje autoriteti kontaktues nuk dhënë asnjë fakt apo argument (se me çfarë sasie te produktit e ka shumëzuar çmimin për njësi, kur dihet fakti se sasia është e përafërt) se si është bazuar te llogaria përfundimtare ku në fund autoritetit kontraktues i ka rezultuar si oferte me çmim me shtrenjtë.

Eksperti shqyrtues sqaron se sipas dispozitave te nenit 54 te Rregullores edhe nënshkrimi i kontratës publike ne këto raste behet sipas çmimit për njësi te kërkuar nga autoriteti kontraktues.

Prandaj, fakti qe autoriteti kontraktues nuk e din sakte sasinë e produkteve me te cilat dëshiron te furnizohet rrjedhimisht nuk mund ta aplikoje këtë llogari sepse përderisa kërkohet qe çmimi te jepet për njësi dhe autoriteti kontraktues publikon sasitë e përafërta atëherë nuk ka kurrfarë sigurie se me çfarë sasie do te furnizohet për ato produkte te cilat i ka publikuar ne paramase.

Andaj, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E ISTOGUT**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Valmir Loshi B.I.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
PRISHTINË/A
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
REPUBLIKA KOSOVA

Florije Rexhepi